



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-2046/25 datë:22.01.2025



Npi – 01/21 datë: 24.01.2025

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 24.01.2025, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -I- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 24.01.2025 (e premte) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, dhe z.Arton Demiri. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtorat: z.Besnik Ahmeti – DBF, znj.Mimoza Salihu-Qeriqi – DSHMS, pastaj zyrtari për Komunitete dhe Kthim z.Muhamet Mehmeti si dhe znj.Vlora Hyseni, zyrtare për informim. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm prej 4 anëtarëve prezent, mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 23.12.2024,
2. Diskutim për organizimin e 15 shkurtit – Dita Memoriale e Komitetit Ashkali,
3. Raporti Vjetor Buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Dhjetor 2024,
4. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, Npi-01/162 dt. 27.04.2023,
5. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit për subvencionimin me 100 euro në muaj Familjet që strehojnë fëmijë pa përkujdesje prindërore Npi-01/237 dt. 04.07.2024,
6. Raport i punës së Komitetit për Komunitete në vitin 2024,
7. Draft – Plani i Punës dhe Orari i mbledhjeve të KPK-së për vitin 2025,
8. Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024,
9. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 23.12.2024

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 23.12.2024.**

Pika 2

Diskutim për organizimin e 15 shkurtit – Dita Memoriale e Komunitetit Ashkali

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha z.Muhamet Mehmetit.

z.Muhamet Mehmeti, zyrtar i ZKKK: Përshëndetje. Ne kemi komunikuar me Organizatat dhe Shoqatat joqeveritare, dhe ato na kanë njoftuar se po e formojnë një Këshill, kështu që ne po presim me na njoftuar me këtë vendim, mirëpo deri sot nuk kemi ndonjë njoftim se a kanë filluar me aktivitete. Kërkesa është për 490 euro për këtë destinim, ne do të bisedojmë me drejtorin e financave lidhur me këtë kërkesë se a ka mjete financiare.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Besoj se drejtori i financave dhe i shëndetësisë, do ta gjejnë një zgjidhje për këtë kërkesë. Këshilli do të ketë përkrahjen e KPK-së. Komuniteti Ashkali në Komunën e Shtimes është i dyti pas komunitetit Shqiptar.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Fillimisht i uroj Muhametit punësimin si zyrtar në Zyrën për Komunitete dhe Kthim. E di që aty ka shumë punë e angazhim por unë besoj se do ja dali. Sa i përket 15 Shkurtit, duhet me ditë për buxhetin se sa po ndahet dhe ta marrim një konfirmim nga drejtoritë. E aktivitetet i bëjnë Shoqatat.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Ne nuk do ta lëmë pa e zgjidhur këtë, por duhet ta shohim se në cilën procedurë duhet ta kryejmë.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Të martën do ta keni kërkesën në drejtori për sa i përket mjeteve financiare. Kisha dashur me qenë një organizim i mirëfilltë, ku do të marrin pjesë edhe Kryetari bashkë me drejtorat në këtë event.

Pika 3

Raporti Vjetor Buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Dhjetor 2024

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dhe Ligjin për Financat Publike dhe Përgjegjësitë, e kemi për obligim që të raportojmë për shpenzimet buxhetore periodike, në këtë rast e kemi raportin vjetor buxhetor për 2024. Materialin po besoj e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, prandaj unë nuk do të lëshohem në detaje por në pikat kryesore. Buxheti i komunës është shpenzuar 11,043,479.98 euro ose 79.20% në total. Në vazhdim lexoi raportin e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike. (Shih raportin) Nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem. Ju ftoj që ti rekomandoni Kuvendit miratimin e këtijë raporti.

znj.Rrezartë Ramadani: Përshëndetje. Unë po kërkoj një sçarim shtesë se qka paraqet ky minusi te faqja e 5 e raportit, nëse mundesh me na sqaru se qka tregon minusi?

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Kudo që e marrim si pozicion, minusi tregon (më pak) psh. më pak se në vitin paraprak nëse po bëhet fjalë për krahasimin e të dhënave.

z.Besnik Seferi: Është mirë që e bërë dallimin te të hyrat vetanake, që ka pas ndikim të madh falja e tatimit në pronë deri në 100 euro. Ky vit është ndër të parët me këtë përqindje kaq të lartë të realizimit të buxhetit me 97.20%.

z.Muhamet Mehmeti, zyrtar i ZKKK: Po jap disa informata për buxhetin në ZKKK-ë, kanë qenë të ndara 8000 euro gjithsej, janë shpenzuar 7956 euro ndërsa kanë mbetur vetëm edhe 44 euro pa u shpenzuar nga viti 2024. Drejtori Besnik Ahmeti na ka ndihmuar për me i adresuar si duhet kërkesat me qëllim që mos me na mbetë pa u shpenzuar në vitin 2024.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Në të kaluarën ka pasur raste që kanë përfituar e njeja familje dy ose më shumë herë, një herë ka përfituar burri e pastaj edhe gruaja e pastaj edhe djali. Po kërkoj nga Muhameti që kjo mos me ndodhë më tash e tutje.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -I- për vitin 2025, të mbajtur më: 24.01.2025, unanimisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratoi Raportin Vjetor Buxhetor të Komunës së Shtimes për Janar – Dhjetor 2024.**

Pika 4

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, Npi- 01/162 dt. 27.04.2023

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Mimoza Salihu-Qeriqi.

znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, drejtoresh e DSHMS: Përshëndetje. Ne kemi përgatitur një ndryshim të vendimit të Kuvendit për këtë vit për rritjen e çmimit nga 250 sa ishte në 300 euro për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës tonë. Nëse ka ndonjë pyetje unë do të përpiqem të përgjigjem. Ju ftoj që ti rekomandoni Kuvendit miratimin e këtij vendimi.

znj.Rrezartë Ramadani: Unë kam një pyetje për drejtoreshën, se a ka dhënë ndonjë arsyetim Këshilli i Bashkësis Islame për ngritjen e çmimit të shërbimeve të varrimit në 300 euro?

znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, drejtoresh e DSHMS: Jo ata nuk kanë dhënë ndonjë propozim, por ne si drejtori kemi bërë para Kuvendit propozimin për rritjen në 300 euro.

z.Besnik Seferi: Inflacioni e bën të veten, kështu që shpenzimet janë rritë. KBI-ja e ka mirëpritur, por edhe qytetarët.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -I- për vitin 2025, të mbajtur më: 24.01.2025, unanimisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes të miratoi Vendimin për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për të gjithë qytetarët që varrosen në territorin e kufijve administrativë të Komunës së Shtimes, në shumën e propozuar prej 300.**

Pika 5

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit për subvencionimin me 100 euro në muaj Familjet që strehojnë fëmijë pa përkujdesje prindërore Npi-01/237 dt. 04.07.2024

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Mimoza Salihu-Qeriqi.

znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, drejtoresh e DSHMS: Edhe te ky rast ne si drejtori kemi propozuar rritjen e subvencioneve për familjet që strehojnë fëmijë pa përkujdesje prindërore, duke e rritur shumën nga 100 euro në 150 euro në muaj. Nëse ka pyetje do të përgjigjem. Ju ftoj që ti rekomandoni Kuvendit miratimin e këtij vendimi.

z.Besnik Seferi: Unë e kam ditë që janë dy ose tri familje të tilla që strehojnë fëmijë pa përkujdesje prindërore. Dmth. me këtë rritje kemi një rritje prej 600 euro në vit, nga 1200 në 1800 euro. Unë jam "Pro dhe do ta votoj.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -I- për vitin 2025, të mbajtur më: 24.01.2025, unanimisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes të miratoi Vendimin për ndarjen nga 150 € për ç'do muaj, për secilën familje që ka strehuar fëmijë pa përkujdesje prindërore në Komunën e Shtimes.**

Pika 6

Raport i punës së Komitetit për Komunitete në vitin 2024

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Materialin për këtë pikë e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar. Në vitin 2024 Komiteti për Komunitete i kemi mbajtur gjithësej 12 mbledhje. I kemi miratuar 32 Rekomandime, dhe 1 vendim. Nëse ka dikush ndonjë pyetje ose ka me diskutu urdhëroni fjala është për ju.

z.Besnik Seferi: Faleminderit prej Sekretarisë së Kuvendit për punën e bërë. Ne kemi bërë përpjekje për me kry punën tonë aq sa kemi mundur dhe ditur. E drejtoritë sa e kanë përfillur është tjetër punë, ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -I- për vitin 2025, të mbajtur më: 24.01.2025, unanimitisht miratoi Raportin e Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2024, si vijon: Mbledhje 12, Vendime 1, Rekomandime 32.**

Pika 7

Draft – Plani i Punës dhe Orari i mbledhjeve të KPK-së për vitin 2025

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Ne e kemi bërë një draft të planit të punës për vitin 2025. Ky draft-plan ndryshon nga ai i mëparshmi sepse është pak a shumë i përmbledhur ku janë përfshi 9 pika si vijon:

1. Përpilimin dhe miratimin e planeve dhe raporteve vjetore,
2. Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve,
3. Rritjen e pjesëmarrjes së komuniteteve në proceset vendimmarrëse lokale,
4. Identifikimin dhe adresimin e nevojave dhe sfidave të komuniteteve,
5. Forcimin e bashkëpunimit me institucionet dhe aktorët relevantë,
6. Rishikimi i rregulloreve dhe akteve komunale për të siguruar që janë në përputhje me të drejtat e komuniteteve,
7. Mbikëqyrja e ndarjes së drejtë të buxhetit dhe financave për komunitetet,
8. Mbështetja e iniciativave për zhvillim ekonomik dhe arsimor të komuniteteve,
9. Fuqizimi dhe monitorimi i mekanizmave për mbrojtjen dhe promovimin e komuniteteve.

Ky Plan do të zbatohet nga Drejtoritë, zyra e Kryetarit si dhe nga Zyra për Komunitete dhe Kthim. Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -I- për vitin 2025, të mbajtur më: 24.01.2025, unanimitisht miratoi Planin e Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2025.**

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -I- për vitin 2025, të mbajtur më: 24.01.2025, unanimitisht miratoi Vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve për vitin 2025, si vijon:**

<i>Nr</i>	<i>Data</i>	<i>Muaji</i>	<i>Viti</i>	<i>Dita</i>	<i>Ora</i>
1	29	Janar	2025	e mërkurë	14.00
2	26	Shkurt	2025	e mërkurë	14.00
3	26	Mars	2025	e mërkurë	14.00
4	28	Prill	2025	e hënë	14.00
5	27	Maj	2025	e martë	14.00
6	23	Qershor	2025	e hënë	14.00
7	03	Korrik	2025	e enjte	14.00
8	27	Gusht	2025	e mërkurë	14.00
9	26	Shtator	2025	e premte	14.00
10	28	Tetor	2025	e martë	14.00
11	24	Nëntor	2025	e hënë	14.00
12	22	Dhjetor	2025	e hënë	14.00

Pika 8

Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Në kuadër të kësaj pike këto ditë kemi pas një rast në komunën tonë për të cilin mendoj se duhet ta diskutojmë. Kemi disa informata që nxënësi me mbiemër Jakupi i komunitetit ashkali në klasën e 6 ka përjetuar dhunë fizike nga një bashkëmoshatar i tij me inicialet

S.S. kështu që përveq dhunës së ushtruar atijë ju kanë marrë edhe të hollat që i ka pas në dispozicion. Ky rast është diskutuar edhe sot në KKSB-ë. Meqenëse Muhameti ka qenë prezent ja kisha kaluar fjalën për të na treguar pak më shumë për rastin.

z.Muhamet Mehmeti: Ka qenë një rast i rëndë, unë jam njoftuar më 20.01.2025 në ora 10h për këtë rast. Ky rast është shpërnda me të madhe edhe në rrjetet sociale. Policia janë njoftuar me rastin më datën 16 Janar, ndërsa supozohet se rasti ka ndodhur më 7 Janar. Me të kuptuar unë së bashku me Kryetarin e Komunës dhe Nënkryetarin kemi shkuar te familja e tijë dhe kemi biseduar. Më pastaj të gjitha masat janë ndërmarrë nga Qendra për Punë Sociale dhe Komuna. Fëmiju është 14 vjeçar dhe nuk mund të merren masa tjera ligjore përveq atyre që janë të parapara nga QPS-ja. Të dy fëmijët kanë qenë problematikë, dhe kanë qenë të suspenduar nga shkolla më parë.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Arsimi fillor është i obligueshëm. Ne po presim se qka po ndërmmerret në vazhdim, mirëpo kjo po tregon për nevojën për një roje më të mirë nëpër shkolla.

z.Besnik Seferi: Unë i njoh të dy prindërit e këtyre fëmijëve. Unë mendoj se është mirë me u ulë dhe me diskutuar me Kryetarin për këtë rast dhe me bërë një zgjidhje në bashkëpunim edhe me OJQ-në “Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin e një shtëpie për këtë familje sepse kanë nevojë.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Komuna ka marrë një vendim për sa i përket banimit të përbalueshëm dhe social, dhe unë mendoj se është rast i mirë për përfshirjen edhe të kësaj familje për ta zgjidhur çështjen e banimit.

z.Muhamet Mehmeti: Unë kamë kërkuar në KKSB-ë që me i ndihmuar kësaj familje me pako ushqimore, ku edhe e kanë marrë përsipër Qendra për Punë Sociale për këto pako të ndihmave. Po ashtu kamë kërkuar që familja e viktimës të jetë për një kohë nën mbikqyrje.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Unë kamë dhënë dorëheqje në KKSB-ë mirëpo sa e kam kuptuar unë duhet të jem patjetër në KKSB-ë si Kryesues i Komitetit për Komunitete sipas Pozitës që kamë, kështu që unë do ta rishqyrtojë dorëheqjen time, me qëllim që me marrë pjesë në mbledhjet e KKSB-së. Unë vërtetë jamë i ngarkuar shumë me punë, kështu që me rastin kur plotësohet Komiteti me anëtarë komplet do ta shikojmë mundësinë se kush mundet me marrë pjesë në KKSB-ë. Do ta shikojmë edhe rregulloren edhe ligjin për këtë.

Pika 9

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi: Jemi në reduktim të anëtarëve të Komitetit për Komunitete, për këtë arsye po të sygjeroj ty Kryesues që takimi i ardhshëm të mbahet me përfaqësimin e plotë të Komitetit për Komunitete. Nuk mund të jetë arsye se punojmë edhe dikund tjetër, sepse gati secili prej neve punojmë edhe dikund tjetër, mirëpo me ligj jemi të liruar që të marrim pjesë në mbledhjet e Komitetit.

znj.Rrezartë Ramadani: Nëse brenda dy ditëve mundemi me i gjetë emrat e anëtarëve të rinjë të Komitetit për Komunitete ne në Kuvend në mbledhjen e datës 27 Janar do të bëjmë një zgjidhje.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Për Shkurten e kemi një emër, ndërsa për Muhametin, duhet me shiku mundësinë se a mundet që IRDK-ja që është parti e komunitetit egjiptian për me pasë përfaqësues këtu.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 15:56h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi

v.v.

Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi